Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

# THIRRJE E HAPUR

## Për aplikim për anëtarësim në Këshillin Lokal për Moshën e Tretë në Komunën e Klinës

Komuna e Klinës, përmes Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shpall **Thirrje të Hapur** për aplikim për anëtarësim në **Këshillin Lokal për Moshën e Tretë**, një trup këshillëdhënës që synon të promovojë mirëqenien, pjesëmarrjen aktive dhe mbrojtjen e të drejtave të personave të moshës së tretë në Komunën e Klinës.

Këshilli do të shërbejë si mekanizëm bashkëpunimi ndërmjet institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile, profesionistëve dhe komunitetit, me qëllim identifikimin e nevojave të personave të moshuar dhe adresimin e tyre përmes avokimit, bashkëpunimit institucional dhe iniciativave lokale.

### Përbërja e Këshillit

Këshilli Lokal për Moshën e Tretë do të përbëhet nga **24 anëtarë**, të përzgjedhur nga këto kategori:

- 1 përfaqësues nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- 1 përfaqësues nga Drejtoria e Arsimit
- 1 përfaqësues nga Qendra për Punë Sociale;
- 1 përfaqësues nga Zyra për Barazi Gjinore;
- 1 përfaqësues nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare;
- 4 përfaqësues nga shoqatat e pensionistëve (2 burra dhe 2 gra);
- 3 përfaqësues nga organizatat joqeveritare;
- 2 përfaqësues nga institucionet arsimore (1 SHFMU qytet dhe 1 Kopshti);
- 3 përfaqësues nga bizneset;
- 2 përfaqësues nga mediat lokale;
- 4 përfaqësues nga asociacionet profesionale ose ekspertë të fushave sociale, shëndetësore, juridike, psikologjike, gerontologjike ose fusha të ngjashme;
- 1 përfaqësues i personave të moshës së tretë nga komuniteti.

**Kush mund të aplikojë?**

Ftohen të aplikojnë:

- institucionet publike;
- organizatat e shoqërisë civile;
- shoqatat e pensionistëve;
- institucionet shëndetësore dhe sociale;
- institucionet arsimore;
- mediat lokale;
- bizneset;
- asociacionet profesionale;
- ekspertë dhe individë me përvojë në fushën e mirëqenies sociale, shëndetit, mbrojtjes së të drejtave të njeriut ose çështjeve që lidhen me moshën e tretë.

**Dokumentacioni i nevojshëm**

Aplikuesit duhet të dorëzojnë:

- Curriculum Vitae (CV);
- Letër motivimi;
- Për organizatat dhe institucionet: letër nominimi ose autorizimi nga institucioni/organizata përkatëse.

**Mënyra e aplikimit**

Dokumentacioni mund të dorëzohet:

- fizikisht në Arkivin e Komunës së Klinës; ose
- në mënyrë elektronike në adresën: agron.bacaj@rks-gov.net

**Afati i aplikimit**

Afati për aplikim është **5 (pesë) ditë kalendarike**, nga data e publikimit të kësaj thirrjeje.

Aplikimet e pranuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

**Përzgjedhja**

Aplikimet e pranuara do të shqyrtohen nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e Komunës së Klinës, në bashkëpunim me stafin e organizatës Syri i Vizionit, me qëllim të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Lokal për Moshën e Tretë.

Procesi i përzgjedhjes do të udhëhiqet duke siguruar përfaqësim sa më gjithëpërfshirës institucional, profesional, gjinor dhe komunitar, në përputhje me Rregulloren e Punës së Këshillit Lokal për Moshën e Tretë.

Për informata shtesë, të interesuarit mund të kontaktojnë Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Klinës.

**Komuna e Klinës**

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**

**Agron BACAJ - Drejtor**